REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr 3408 Prot Maliq, më 01 .06 .2026

V E N D I M
Nr. 72 datë 29.05.2026

Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 19 datë 30.01.2026, "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë Maliq".

Bazuar në: ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen vendore* "i ndryshuar neni 8 pika 2, neni 9 pika 1, nënpika 1.2 germa b, neni 64 pika c; ligji nr. 57/2020 "*Për pyjet*"; ligji nr.9693 datë 19.03.2007 "Për fondin Kullosor" i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 433 datë 8.6.2016 "*Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...*", i ndryshuar; Urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 299 datë 04.10.2022 "*Për miratimin e planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore të Bashkia Maliq*"; Udhëzimi nr. 1, datë 09.06.2016 i Ministrit të Mjedisit "*Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik*"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 559 datë 29.07.2022 "*Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor*"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.467 datë 31.07.2025 "*Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme*", VKB nr. 19 datë 30.01.2026 "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë Maliq", Kërkesës për ndryshim sipërfaqe nr. 666 prot datë 04.03.2026 ; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Miratimin për ndryshimin e sipërfaqes nga 20 m² në 100 m² për dhënien në përdorim në ngastrën nr. 39c të Ekonomisë Pyjore Moglicë, Fshati Gurshqipe, Njësia Administrative Moglicë, Bashkia Maliq, me qëllim ngritjen e një Antene Telefonike nga kompania Vodafone Albania sh.a.
2. Ngarkohet Sektori i Pyjeve dhe Kullotave për fillimin e procedurave për hartimin e raportit tekniko-ekonomik për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor me sipërfaqe 100 m² me objekt ngritjen e Antenës Telefonike.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi Bashkia Maliq nxjerr certifikatat e pronësisë të ngastrave që do jepen në përdorim dhe lidh kontratën e qirasë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.

Miratuar me 18 vota
Vota pro 18
Vota kundër 0
Vota apstenim 0
Zbardhur më datë 01.06.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ